

Njoftim për Shtyp

Zhvillohet mbledhja e rradhës e Komisionit të Pavarur Ad-Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatisë

Në institucionin e Avokatit të Popullit, në datë 12.10.2023, ora 15.00, u zhvillua mbledhja e rradhës e Komisionit të Pavarur Ad-Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatisë.

Pjesëmarrës në mbledhje ishin Avokatja e Popullit, znj. Erinda Ballanca, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit, anëtarët z. Sandër Simoni, z. Shaban Sinani dhe z. Ilir Dode, ndërkohë që anëtari tjetër z. Maksim Haxhia për arsye objektive nuk ishte prezent në mbledhje.

Në përputhje me rendin e ditës, Kryetari i Komisionit informoi mbi përgjigjet e ardhura nga Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit si dhe më pas u kalua në verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të pesë kandidatëve, ku pas shqyrtimit, Komisioni konstatoi mospërmbushjen e plotësimit të kriterëve ligjore nga një prej kandidatëve.

Ndërkohë, për kandidatët e tjerë u vendos që të vijojë hetimi administrativ dhe se vendimi për këta kandidatë do të bëhet publik pasi të kenë ardhur përgjigjet nga institucionet përkatëse të cilave i'u është kërkuar informacion nga Komisioni në lidhje me përmbushjen nga ana e tyre të kriterit të integritetit.

Komisioni rikonfirmoi që mbledhja e rradhës do të zhvillohet në datën 13 tetor 2023, ora 14.00, në ambientet e institucionit të Avokatit të Popullit, ku do të vazhdohet me shqyrtimin e verifikimit të plotësimit të kriterëve ligjore nga kandidatët.